VENDIM
Nr. 164, datë 6.10.2016

MBI MIRATIMIN E KONTRATËS TIP PËR VERIFIKIMIN DHE VULOSJEN E MATËSVE ELEKTRIKË

Në mbështetje të neneve 16 dhe 77, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", ligjit nr. 9875, datë 14.2.2008, "Për metrologjinë", i ndryshuar, dhe Kodit të Matjes, i ndryshuar, nenit 26 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.10.2016, mbasi shqyrtoi draftin e kontratës tip për verifikimin dhe vulosjen e matësve elektrikë dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s,

konstatoi se:

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, me shkresën e protokolluar në ERE nr. 581/8, në datën 28.9.2016, ka depozituar propozimin për miratimin e kontratës tip për verifikimin dhe vulosjen e matësve elektrikë.

Për qëllime të konsultimit mbi përmbajtjen e draftit, pas botimit në gazetë të njoftimit për fillimin e procedurës së miratimit të draftkontratës tip, ERE ka kërkuar opinionin e Autoritetit të Konkurrencës, MEI-t, OSHEE sh.a. dhe subjekteve të autorizuara nga DPM-ja.

ERE ka organizuar disa seanca dëgjimore me të gjitha palët e interesit, me qëllim diskutimin e draftkontratës tip për verifikimin dhe vulosjen e matësve elektrikë.

OSHEE sh.a., me shkresën nr. 21699/1 prot., datë 4.10.2016, ka shprehur dakordësinë e saj mbi këtë draft.

ERE, në bazë të nenit 77, pika 10, të tigjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", ka detyrimin të miratojë kontratën tip për verifikimin dhe vulosjen e matësve elektrikë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kontratën tip për verifikimin dhe vulosjen e matësve elektrikë (bashkëlidhur kontrata dhe 29 anekset e saj).

2. Tarifat për verifikimin e matësve, siç shprehur në aneksin nr. 1, "Mbi listën e çmimeve tavan njësi", në zbatim të nenit 77, pika 8, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Ministrisë së Financave.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti